

PROGRAMI NR. 1

“Transferimi i Teknologjive qe Sigurojne Rritjen e Qendrueshme te Prodhimit te Mishit ne Fermat Blegtorale”

Rekomandimet :

Per gjedhin

- 1.** Mbareshtimi i viçave per majmeri kerkon medoemos qe viçat te jene kryqezime te racave mishatake. (Limuzine, Sharole, Simental per mish, etj.).Racat mishatake ose kryqëzimet me raca mishi kanë dinamikë shtese peshe dhe koeficient të shpërblimit të ushqimeve më të mirë se ato të racave të qumështit. Viçat që janë të racave të qumështit nuk e justifikojne shpenzimin e bërë.
- 2.** Rritja e peshës së therjes është më efektive tek rracat me drejtim mishi ndërsa tek racat e qumështit treguesit e kostos mbeten pothuajse konstant.
- 3.** Sisitemi i mbareshtimi te viçave ne majmeri duhet te jete i kombinuar (regjim stallor, kullote).
- 4.** Për të realizuar një t’ushqyer më efikas grupimi i viçave ne majmeri, në stallë, të bëhet sipas racës e seksit dhe jo vetëm peshës.
- 5.** Në fermat, ku te ushqyerit bazohet ne ushqimet e blera në treg të ardhurat e fermerit jane me te ulta, prandaj te ushqyerit e viçave per majmeri duhet te bazohet ne ushqimet e prodhuara dhe pergatitura ne ferme.
- 6.** Lopët, viçat e te cilave nuk mbahen për remontimin e tufës të ndërzehen me raca mishi.
- 7.** Ndërtimi i stallave me tregues bashkohor për rritjen e viçave ose përshtatja e atyre egzistuese me bokse duke regulluar dhe ndriçimin e sidomos ajrosjen do të sillnin një përmirësim tërësor në kondicion.

Per derrin

1. Rekomandohen racionet ushqimore sipas normave te percaktuara ne varesi te kategorive dhe gjendjes fiziologjike te kafshes :

*Shëmbuj te racioneve ushqimore për paradosat, riprodhuesit
25 deri 100 kg .*

Nr	Përbërësit në %	I	II	III	IV	V	VI
1	Elb	78	43.5	25	25	20	16
2	Misër	x	x	x	34	27	
3	Grur	x	20	28	x	x	40
4	Tërshër	x	x	5	x	5	x
5	Manioc 65	x	x	x	x	x	10
6	Krunde	x	x	5	5	x	x
7	Melas	x	5	5	3.5	6	x
8	Bërsi soje 48	15.5	10	13.6	11.1	14.5	16.5
9	Bizele të pranverës	x	15	14	15	13	13
10	Miell peshku 70	2	2	x	2	x	x
11	Karbonat kalciumi	1.4	1.2	1.2	1.3	1.2	1.2
12	Fosfat bikalcik	2.1	2.3	2.2	2.1	2.3	2.3
13	C.O.V.	1	1	1	1	1	1
Cilësitë e ushqimeve në 1 kg							
14	Energji e tretëshme ED	3018	3063	3027	3125	3044	3135
15	M.A.T. (gr)	162.1	159.4	163.0	161.9	160.0	166.5
16	Lizinë (gr)	8.48	8.59	8.47	8.74	8.54	8.75
17	Metioninë + Cistinë (gr)	5.87	5.47	5.51	5.51	5.39	5.55
18	Calcium (gr)	11.46	11.50	10.94	11.21	11.14	10.99
19	Fosfor (gr)	7.90	7.86	7.83	7.77	7.91	7.54

- *Të ushqyerit e dosave*

N/r	Nevojat energjitike	K.kal E.D./ ditë
A	Barsmëri*	x
1	Në fillim të barsmërisë deri më 93 ditë.	7800
2	Fundi i barsmërisë.	8400
B	Me qumësht	x
1	Me 9 gica	17000
2	Me 10 gica	18000

*Korigjohet sipas kushteve të mbarështimit , dhe lëvizjes së peshës së tyre

Shëmbuj te racioneve ushqimore të riprodaktorëve

Nr	Emërtimi	barsmëri		laktacion; * dhe barsmëri + laktacion		
		Për 1000 K. calED	Për kg.	Për 1000K calED	Për kg ushqim në laktacion	Për kg ushqim në laktacion* barsmëri
1	E. D. (K.cal)	1000	2900	1000	3100	3060
2	Lënda azotike totale (L.A.T.)	40	120	45	140	140
3	Lizin (gr)	2.2	6.4	2.5	7.75	7.6
4	Metionin +Cistin (gr)	1.4	4.1	1.6	5.0	4.9
5	Treonin (gr)	1.4	4.1	1.6	5.0	4.9
6	Triptofan (gr)	0.5	1.45	0.5	1.55	1.52
7	Kalcium (gr)	3.3	9.6	3.3	10.2	10
8	Fosfor Total (kg)	2.4	7	2.4	7.4	7.3
9	Celuloz (gr)	X	40-70	x	35-50	40-60

2. Uji duhet te jete sigurisht i paster dhe i vendosur prane koritave te ushqimit. Kur pirja behet me piresë , nje piresë ne forme gishti duhet tu korrespondoje rreth 15 derrave. Per gicat ato vendosen 15 cm nga dyshemeja , per derrat 40 cm per dosat 50 cm. Nevojat e Doses ne periudhen e laktacionit jane 35- 40 lit uje ne dite. Sasia e ujit qe rjedh nga nje pirse eshte. 2.2 lit uje / ne minute. Gici ka nevojë per 4 lit. uje ne dite dhe sasia e ujit qe rjedh nga nje pirse per kete kategori eshte 0.5 lit uje / ne minute. Gicat pires pas moshes 3 javeshe kane nevojë per uje shtese pamvaresisht qumeshtit qe pijnë tek nena.
3. Ushqimet e blera duhet te shoqerohen me flete analize.
4. Pesha ne therje (110-120 kg) te arrihet brenda afatit kohor 5-5.5 muaj optimumi.
5. Rekomandohet qarkullimi i harçave ne nderzim natyral per te menjanuar efektin e bashkegjakesise.
6. Ne fermt qe aplikohet Inseminimi Artificial me matetrial te fresket, duhet qe sperma e prodhuar per çdo riprodaktor ti nenshtrohet kontrollit ne Laboratorin e References QTTB,Fushe-Kruje.

7. Hibridi i prodhuar (harçe reproduktor) produkt i Qendres ALBIDEA, Xhafzotaj, rezultoi me tregues potencial ne zhvillimin e gicave: Pesha në lindje dhe këputje kane influencë për gjithë periudhën e mëvonshme të rritjes, deri në 6 muaj ato kane ndikim të madh.
8. Per mjameri mbarshtoni gica qe vijne nga kryqezime me raca te pershtatshme per kushtet e rritjes gjysem intensive qe dallohen per intesitet te larte rritjeje dhe kosto te vogel te shpenzimeve,(E.Bardhe e Madhe,Hybrid).Do te rritet madhesia e çerdhes nga 7-8 gica ne 9-11 gica duke sjelle permiresimin e dinamikës se rritjes se gicave nga 550 gr ne 650 gr.ne dite.
9. Lageshtia e ajrit ne stalle eshte ne raport te drejte me temperaturën. Ajo normalisht duhet te jete ne shifrat 50-60 %. Konkretisht dyshemeja e stalles duhet te jete me skare pasi lageshtia relative e ajrit eshte rreth 50% kundrejt 75-85 % qe verehet ne dyshemene e zakonshme. Skara mund te jene ne forme plastike ose metalike.
- 10.Rregullimi i ajrit ne stalle eshte domosdoshmeri dhe realizohet duke vendosur deflektoret pergjate siperfaqes anesore te stalles, ndersa ne pjesen ballore vendosen aspiratoret te cilet duhet te jene mundesishit me qender komandimi.
- 11.Temperatura : Rekomandua qe ne periudhen 24-28 ore para pjelljes temperatura e larte ndikon negativisht ne ardhjen ne afshin pasardhes pas keputjes. Ne bokset qe konsiderohen si maternitet ajo duhet te jete 18-20 grade C dhe kjo duhet te sigurohet nepermjet nje burimi nxehtesie (llampe infra te kuqe ose ngrohese) per te siguruar ngrohjen e gicave te porsalindur,te cilet jane shume te ndjeshem ndaj temperaturave te ulta dhe te paafte ta rregullojne ate.

Per shpendet

1. Mbarshtimi i pulave per mish (brojler) te linjave ROSS she KOB ne kushte gjysem intensive rrit efektivitetin ekonomik te prodhimit te mishit te shpendeve ne ferma.
2. Mbarshtimi i ketyre linjave sjell permiresimin e dinamikës se zhvillimit :
 - Nga 25 gr ne dite ne 27 gr ne dite
 - Shkurton afatin ne therje te broilerve nga 49 dite ne 42dite
 - Permireson efektivitetin e konsumit te ushqimit me 2,4 kg ushqim per kg mish te prodhuar.

3. Shkurtimi i kohes se rritjes do te rrise mundesine per me shume cikle ne vit nga 4 ne 5 per te njetin strehim .
4. Perdorimi i ushqimeve ne forme te peletuar, permireson tretjen ne brojler dhe rrit higjenen e ushqimeve deke arritur peshen ne therje te broilerve ne moshen ne 42 dite 1900gr.
5. Perdorimi i racioneve te ballancuara ne brojler rrit shtesat ditore te peshes, shkurton kohen e mbajtjes dhe majmerine e ty re duke ulur shpenzimet dhe koston e ushqimit me 3100 leke ne 1000 pula/mish.
6. Racionet ushqimore ne varesi te fazes fiziologjike te zhvillimit te zogjve:

Nr.	Perberja ne racion	Faza e pare	Faza e dyte
1.	Proteina bruto	23%	21 %
2.	Energji e metabolizuar	3100 kalori	3200 kalori
3.	Celuloze bruto	3.5 %	3.5 %
4.	Yndyre	4.6 %	5.9 %
5.	Rapoti energji / proteine	1 / 135 %	1/ 152 %
6.	Ca	1.1 %	0.9 %
7.	Fosfor	0.55 %	0.50 %
8.	Kripe gjelle	0.25 %	0.25 %
9.	Metionine	0.48 %	0.44 %
10.	Metionine + cistine	0.37 %	0.32 %
11.	lizine	1.25 %	1.25 %

Drejtuese e Programit nr.1
Prof.Ass.Dr. Fatmira LEKA (SULAJ)